



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 1195/4 prot.

Tiranë, më 30 . 12 . 2024

**V E N D I M**

**Nr. 327, datë 30.12.2024**

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 175, datë 27.08.2024, e bërë nga znj. M.M kundër Njësisë së Mbrojtjes së Fëmijëve (NJMF) të Bashkisë Shkodër, me pretendimin për diskriminim, për shkak të “aftësisë së kufizuar<sup>1</sup>”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I :**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Sipas shpjegimeve të dhëna, subjekti ankues në mes të tjerash informon se: “Kam qënë e martuar në Mal të Zi me M.P, shtetas nga Mali i Zi, me të cilin kam një vajzë D.M e cila ka mbajtur mbiemrin tim (nga martesë e parë) dhe në çertifikatë vajza D mban emrin e bashkëshortit tim të parë. Gjatë bashkëjetesës time me M.P kam pësuar dhunë të vazhdueshme nga ai dhe si pasojë jam larguar nga shtëpia dhe kam ardhur tek prindërit e mi në Shqipëri, vajza ngeli atje dhe ai ka filluar një bashkjetesë me një grua tjetër. Pas disa kohësh M.P përfundoi në burg për dhunë dhe aktualisht ndodhet në burg. Pastaj vajzën time e ka marrë shërbimi social dhe ata e kanë dërguar në një familje, por unë nuk e di ku është vajza aktualisht. Mua nuk më kanë lejuar ta marr vajzën dhe as familjen time dhe nuk kemi mundur ta takojmë prej 5 muajsh dhe nuk e di ku ndodhet. Pak kohë më parë punonjës të Policisë Shkodër dhe të Bashkisë kanë ardhur të më takojnë për të më pyetur se a mund ta mbaj vajzën për shkak të sëmundjes time (nuk e di nëse Shërbimi Social i Podgoricës ka njoftuar palën Shqiptare dhe për këtë pastaj është vendos në lëvizje NJMF Shkodër). Unë u kam thënë se jam në gjendje ta mbaj vajzën përtej problemit tim shëndetësor plus unë jetoj me nënën dhe nga ana financiare, janë dhe familja që mund të më ndihmojë të mbaj

<sup>1</sup> Referuar Vërtetimit për Aftësinë e Kufizuar, nr. AK-2023-002058, datë 27.01.2023, të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror.

vajzën ashtu siç mbaj dhe vajzën tjetër. Punojësit e Njesisë së Mbrojtjes së Fëmijëve Shkodër kanë përgatit disa letra por nuk kam asnjë informacion më shumë se çfarë është bërë me rastin e vajzës time. Unë mendoj se po diskriminohem për shkak të sëmundjes time, pasi më shikojnë si të paafte për të mbajtur fëmijën por gjithsesi unë kam të drejtë të di si dhe ku është vajza ime dhe pse nuk mund ta takoj dhe ta marr me vete në shtëpi”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe gjetjen e vajzës.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

**Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.**

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga LMD dhe që lidhen me pretendimin e ankueses për diskriminim të djalit të saj nga subjektet sipërcituar.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

- Me shkresën nr. 1195/1, datë 04.09.2024, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga Bashkia Shkodër, Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve, për ankesën e bërë dhe ka kërkuar aktet e poshtë cituara:
  - Procedurën e ndjekur nga ana e Njesisë së Mbrojtjes së Fëmijëve, së Bashkisë Shkodër.

- Kopje të akteve shkresore, relacioneve, raporteve të ndryshme, procesverbale të mbajtura apo komunikime shkresore me institucione të tjera, lidhur me adresimin apo masat për ndjekjen e zgjidhjen e problematikës së ankueses.
- Kopje të praktikave të qytetarëve të tjerë, të cilët kanë pasur problematikë të njëjtë apo të ngjashme me ankuesen. Cila është procedura e ndjekur? Si është vepruar me ta?

Bashkia Shkodër me shkresën nr. 17838/1, datë 18.09.2024, në mes të tjerash ka informuar Komisionerin se: *“Znj. M.M nuk ka paraqitur asnjë kërkesë/ankesë për informacion të administruar nga Drejtoria e Shërbimit Social dhe Njesisë së Mbrojtjes së Fëmijëve për problematikën e saj. Znj. M dhe familja e saj banojnë në Lagjen nr. 2, por specialistja e Qendrës Komunitare “Për Familjen”, nr. 2, pranë Drejtorisë së Shërbimit Social e ka takuar vetëm një herë në vitin 2021, gjatë mbështetjes me pako ushqimore për familjen P, ndërsa specialistja e Njesisë së Mbrojtjes së Fëmijëve, nuk e ka takuar asnjëherë znj. M.M.*

*Pas kërkesës që ka bërë me e-mail Agjencia Shtetërore e Mbrojtjes së Fëmijëve për vlerësimin e familjes së znj. M.M, specialistja e Qendrës Komunitare “Për Familjen” nr. 2, pranë Drejtorisë së Shërbimit Social, ka marrë kontakt edhe me Qendrën Komunitare të Shëndetit Mendor në qytetin e Shkodrës, me mjekun neuropsikiatër z. Gj.P, dhe nga informacioni mjekësor datë 09.04.2024, evidentohet se znj. M vuan nga çrregullime të shëndetit mendor.*

*Si rezultat i kësaj gjendjeje shëndetësore, anëtarët e komisionit shumëdisiplinor të vlerësimit të aftësisë së kufizuar e kanë përfshirë znj. M.M si përfutuese e kempit të aftësisë së kufizuar.*

*Gjendja shëndetësore e znj. M asnjëherë nuk është trajtuar si shkak për diskriminim nga ana e punonjësve të shërbimit social, të Bashkisë Shkodër.*

*Sipas certifikatës familjare rezulton se shtetasja M.M.P është e bija e P.P dhe D.P, e ditëlindjes 21.08.1989, lindur dhe banuese në Shkodër. Znj. M.M rezulton me status civil “e martuar” (kjo sipas certifikatës) dhe nënë e dy vajzave, konkretisht:*

- D.P e datëlindjes 11.12.2011 (rezulton pa atësi)
- D.M e datëlindjes 05.09.2013 (me atësi: N...)

*Znj. M.M nuk ka kërkuar dhe nuk ka marrë shërbime pranë shërbimit social të Bashkisë Shkodër dhe në këto kushte nuk është përballur me “një trajtim të padrejtë dhe jo të barabartë” nga Shërbimi Social/Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve.*

*Për pretendimet e zonjës, se nuk ka dijeni ku ndodhet vajza që jeton në Mal të Zi, janë struktura të tjera shtetërore që duhet të japin këtë informacion.*

*Përmes programeve sociale, Drejtoria e Shërbimit Social në Bashkinë Shkodër, ka mbështetur familjen P prej disa vitesh duke e përfshirë në një sërë programesh të zhvilluara në Qendrën Komunitare “Për Familjen” nr. 2 dhe konkretisht vajzën D.P, që jeton në shtëpi me gjyshen e saj nga nëna, znj. D.P, në Shkodër.*

*Në takimet dhe aktivitetet që organizon QKPF-ja nr. 2, fëmija D.P, shoqërohet në të gjitha rastet nga gjyshja D.P. Në të gjithë komunikimet e specialistes së Qendrës Komunitare “Për Familjen” nr. 2, me këtë familje, ka qenë gjithmonë gjyshja, si dhe mbështetja për fuqizim ekonomik është nënshkruar nga znj. D.P”.*

### **III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

#### **A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë e të pafavorshëm.**

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me parashikimet ligjore ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e ankueses, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e saj për trajtim të padrejtë dhe diskriminues.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre”.*

LMD në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacion në përmbushjen e detyrave të tij”.*

Nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë marrë të gjitha masat që subjekti kundër të cilit është bërë ankesa të vihet në dijeni për ankesën e bërë dhe i janë ofruar mundësitë që të jepte shpjegime, informacion dhe dokumentacion provues mbi pretendimet e ngritura nga subjekti ankues.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktima e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në *“shkakun e mbrojtur”*.

Një nga format e diskriminimit parashikuar nga ligji, është diskriminimi i drejtpërdrejtë, i cili përkufizohet nga neni 3/2, i ligjit si një situatë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji.

Në nenin 5, pika 1, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar përcaktohet se: *“1. Ndalohet diskriminimi për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe*

*mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, e një ankimi ose procedurë, si dhe çdo formë tjetër sjelljeje që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë”.*

Në Kreun IV, të LMD-së parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve. LMD në nenin 20/1/a dhe b dhe pika 2/c<sup>2</sup>, ndalon çdo lloj dallimi, kufizimi ose përjashtimi, që i bëhet një personi apo grupi personash në ofrimin e të mirave dhe shërbimeve.

Bazuar në dispozitat e mësipërme ligjore, të cilat japin përkufizimin e diskriminimit, për të arritur në përfundimin se ankuesja është diskriminuar duhet të plotësohen njëkohësisht 3 elementë:

- është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshme. Ky trajtim mund të realizohet me veprime ose mosveprime, duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi;
- në krahasim me sesi janë trajtuar ose do të trajtoheshin të tjerët në një situatë të ngjashme;
- dhe arsyeja për këtë trajtim të padrejtë është një nga shkaqet që gëzojnë mbrojtje nga ligji.

Sa më sipër, për të vlerësuar pretendimin për diskriminim të parashtruar nga ankuesja, në radhë të parë Komisioneri do të vlerësojë nëse ajo i është nënshtruar ndonjë trajtimi të pabarabartë dhe më pak të favorshëm, në të drejtën e saj për të përfituar të mira apo shërbime dhe më konkretisht në lidhje me mosmarrjen e masave nga ana e Njësisë së Mbrojtjes së Fëmijëve të Bashkisë Shkodër.

*Bazuar në deklaratimet e provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës dhe kronologjisë së ngjarjeve, rezultoi se:*

Ankuesja M.M, është person me aftësi të kufizuara, me status civil “e martuar” dhe nënë e dy vajzave: D.P dhe D.M. Ankuesja pretendon se nga ana e Njësisë së Mbrojtjes së Fëmijëve të Bashkisë Shkodër, nuk janë marrë masat për ta mbështetur atë, për vajzën e saj që jeton në Republikën e Malit të Zi.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të shqyrtuar rezulton se:

Me e-mail-in datë 08.04.2024, Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve, ka kërkuar nga Shërbimi Social i Bashkisë Shkodër informacionin si më poshtë: *“Me kërkesë të Ambasadës Shqiptare në Podgoricë Mali i Zi, kërkojmë bashkëpunimin tuaj për të bërë të mundur identifikimin e nënës së fëmijës D.M. Autoritetet kërkojnë gjithashtu informacion lidhur me të ëmën e fëmijës dhe vlerësimin e rastit nëse ajo mund të kujdeset për fëmijën në rast riatdhesimi”.*

---

<sup>2</sup> Neni 20/1/a dhe b dhe pika 2/c, të ligjit nr. 10221/2010: *“Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t'i arrijë ose t'i përdorë ato: a) duke refuzuar t'i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi...”; 2. Pika 1 e këtij neni zbatohet veçanërisht për: c) kontributin dhe mundësinë për të përfituar të mira nga skemat e mbrojtjes shoqërore, duke përfshirë asistencë sociale, sigurime shoqërore, mbrojtje të fëmijëve, përfitim për shkak të aftësisë së kufizuar, apo ndonjë skemë tjetër të mbrojtjes sociale ose avantazh tjetër social të ofruar për publikun;*

Në përgjigje të kërkesës për informacion, Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik, e Bashkisë Shkodër, në mes të tjerash ka informuar se: “..... Nga martesë e znj. M me një shtetas Malazes, kanë ardhur në jetë dy vajza, D.M dhe D.P. Pas ndarjes dhe largimit nga bashkëshorti, znj. M nuk kujdesej dhe nuk mbante përgjegjësi për vajzat e mitura dhe si rrjedhojë D ka vazhduar të jetojë në Mal të Zi ndërsa D qëndroi me gjyshen e saj znj. D.P. Përfaqësues të Drejtorisë së Shërbimit Social morën takim me znj. D.P, nëna e znj. M.M, nga ku mësuan se znj. M ishte shpërngulur për të jetuar në Kosovë dhe me familjen mbante kontakte telefonike. Njëkohësisht morën kontakt dhe me shefin e psikiatrisë Komunitare në qytetin e Shkodrës, mjekun psikiatër z. Gj.P, nga ku mësuan se znj. M vuan nga çrregullime të shëndetit mendor. .... Me datë 09.04.2024 është mbajtur dhe një takim me Drejtorinë e Policisë të Qarkut Shkodër për komunikimin e problematikës, nga ku u vumë në dijeni se sipas sistemit TIMS, znj. M rezultoi se ndodhet në shtetin e Malit të Zi. Bashkia Shkodër përmes strukturave të specializuara ka mbështetur familjen prej disa vitesh, duke e përfshirë familjen në një sërë programesh të mbështetura nga organizata joqeveritare dhe të strukturave të bashkisë”.

Me shkresën nr. 5334/2, datë 07.08.2024, Drejtoria Vendore e Policisë Shkodër, ka kërkuar informacion nga Drejtoria e Shërbimit Social të Bashkisë Shkodër, në të cilën ka kërkuar informacionin si më poshtë: “Qendra për Punë Sociale në Podgoricë ka marrë në kujdestari fëmijën e mitur (D.M) dhe informon se fëmija ka kohë që është shkëputur nga nëna e saj biologjike dhe jeton në Malin e Zi. Nga verifikimet e kryera në sistem rezultoi se fëmija D.M për herë të fundit ka dalë nga RSH me datë 06.08.2022, nga pika kufitare Hani i Hotit. Për sa më sipër, kërkohet informacion për gjendjen psiko-sociale të familjes së shtetasës M.M. Kjo familje a i plotëson kushtet për marrjen në kujdestari të të miturës D.M”.

Në përgjigje të kërkesës për informacion, Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik, e Bashkisë Shkodër, me shkresën nr. 16589/1, datë 22.08.2024, në mes të tjerash ka informuar se: “..... Znj. D.P, nëna e znj. M.M kujdeset për mbesën e saj D.P. Znj. D jeton në banesën e saj dhe kohët e fundit është vënë re që kushtet ekonomike dhe higjieno-sanitare janë përmirësuar. Ndërkohë e mitura D.P ka mbaruar klasën e 6-të në shkollën “Miqësia” dhe shprehet se ndihet mirë me stafin pedagogjik dhe shokët e shoqet e klasës. ....

Në lidhje me faktin nëse familja e znj. M.M (P) i plotëson kushtet për marrjen në kujdestari të të miturës D.M, Drejtoria e Shërbimit Social e vlerëson si kompetencë të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.

Nisur nga fakti se çështja e kujdestarisë së të miturve është kompetencë e gjykatës, pala kërkuuese duhet të paraqesë kërkesën pranë kësaj gjykate dhe vetëm nëse i plotëson kushtet e vendosura nga Kodi i Familjes, atëherë mund të arrijë marrjen e të miturës në kujdestari”.

Rregullat për sigurimin dhe ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, të cilat ndihmojnë në mirëqenien dhe përfshirjen shoqërore të individëve e të familjeve që kanë nevojë për kujdes shoqëror, përcaktohen në ligjin 121/2016 “Për shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”.

Në nenin 5 të këtij ligji përcaktohen kategoritë e përfituesve të shërbimeve të kujdesit shoqëror:

1. *Të drejtën për të përdorur shërbimet e kujdesit shoqëror e kanë individë ose familje që nuk kanë mjetet minimale të jetesës dhe nuk janë në gjendje që t'i sigurojnë ato me punë apo të ardhura nga pronat ose burime të tjera, si dhe të gjithë individët që janë në pamundësi për të plotësuar nevojat e tyre të jetesës, vetë ose me ndihmën e anëtarëve të familjes, për shkak të kushteve personale dhe sociale.*
2. *Shërbimet e kujdesit shoqëror përdoren nga shtetasit shqiptarë me banim në Republikën e Shqipërisë.*
3. *Shërbimet e kujdesit shoqëror përdoren edhe nga shtetasit e huaj, personat pa shtetësi dhe refugjatët, por me banim në Republikën e Shqipërisë. ....*

Në nenin 7 të ligjit cipërcituar përcaktohen kategoritë që nuk përfitojnë shërbime të kujdesit shoqëror, si më poshtë:

- a. *shtetasit shqiptarë që banojnë jashtë vendit;*
- b. *azilkërkuesit, të cilët nuk kanë marrë statusin e azilit;*
- c. *shtetasit shqiptarë, shtetasit e huaj ose personat pa shtetësi, të cilët kanë nevojë për ndihmë emergjente, si pasojë e fatkeqësive natyrore dhe luftërave;*
- ç) *personat që vuajnë dënim me heqje lirie, me vendim të formës së prerë të gjykatës”.*

Në nenin 36, parashikohet roli i Bashkisë dhe në nenin 37 roli i punonjësit social të njësisë së qeverisjes vendore:

*“1. Bashkia ofron dhe administron shërbimet e kujdesit shoqëror brenda territorit të saj:*

- a. *duke identifikuar nevojat;*
  - b. *duke vlerësuar nevojat në bazë të hartës së vulnerabilitetit;*
  - c. *duke hartuar planin social vendor;*
  - ç) *duke programuar buxhetet vendore;*
  - d. *duke planifikuar shportën bazë të shërbimeve shoqërore;*
  - dh) *duke kontraktuar ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror me anë të procedurave të prokurimit, sipas legjislacionit në fuqi për prokurimin publik;*
  - e. *duke bashkërenduar me Shërbimin Social Shtetëror shërbimet e nevojshme të kujdesit shoqëror.*
2. *Për administrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror pranë bashkive ngrihen struktura të posaçme për shërbimet e kujdesit shoqëror.*
  3. *Pranë çdo njësie administrative, në varësi të bashkisë, ngrihet njësia e vlerësimit të nevojave dhe referimit.*
  4. *Bashkia cakton nga një punonjës social të njësisë së qeverisjes vendore për gjashtë deri në dhjetë mijë banorë.*
  5. *Bashkitë, me numër popullsie më pak se gjashtë mijë banorë, orientohen dhe mbështeten në*

*funksionet e tyre nga zyrat rajonale të Shërbimit Social Shtetëror.*

*Neni 37*

*Punonjësit socialë në njësinë e qeverisjes vendore janë pjesë e strukturës së posaçme për shërbimet e kujdesit shoqëror dhe/ose njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit të rastit dhe kanë për detyrë:*

- a. të verifikojnë gjendjen shoqërore dhe ekonomike të individëve e të familjeve që kanë nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror nëpërmjet identifikimit të rasteve;*
- b. të ndihmojnë në përgatitjen e dokumentacionit për personat që aplikojnë për përfitimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror nëpërmjet këshillimit, ndërmjetësimit dhe referimit në shërbimet sociale në nivel vendor, rajonal apo kombëtar;*
- c. të marrin pjesë në procesin e hartimit të planeve të kujdesit për personat që do të trajtohen apo të cilëve u refuzohen shërbimet e kujdesit shoqëror nëpërmjet vlerësimit, ndjekjes, monitorimit dhe mbylljes së rastit;*
- ç) të përgatitin dokumentacionin dhe propozimet për miratim nga këshilli bashkiak;*
- d) të grumbullojnë dhe të hartojnë informacione, statistika dhe të mbajnë regjistrin e përfituesve, të ndjekin shpenzimet për personat që kanë nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror;*
- dh) të grumbullojnë informacione për rrjetet e shërbimeve publike dhe jopublike që veprojnë në territorin e bashkisë”.*

Ligji nr. 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”, në nenin 1, të tij, ka përcaktuar se:

*“Ky ligj përcakton të drejtat dhe mbrojtjen që gëzon çdo fëmijë, mekanizmat dhe autoritetet përgjegjëse, që garantojnë me efektivitet ushtrimin, respektimin, promovimin e këtyre të drejtave, si dhe mbrojtjen e veçantë të fëmijës”.*

Ligji nr. 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”, është kujdesur gjithashtu, që në nenin 30, të tij, të përcaktojë edhe të drejtat e detyrimit e personit që ushtron kujdesin prindëror të fëmijës, duke përcaktuar shprehimisht se:

*“1. Prindi ose kujdestari ka detyrimin t’i sigurojë fëmijës mirëqenien emocionale, fizike, sociale e materiale, duke u kujdesur për të dhe duke marrë masat e nevojshme për ushtrimin e të gjitha të drejtave të parashikuara në këtë ligj.*

*2. Në rast se prindi ose kujdestari, pavarësisht vullnetit, nuk arrin përmbushjen e detyrimeve të parashikuara në pikën 1, të këtij neni, njësia e mbrojtjes së fëmijës merr masa për të ndihmuar prindin në realizimin e detyrimeve ndaj fëmijës. Në rast se edhe pas ndihmës së dhënë rezulton se qëndrimi i mëtëjshëm i fëmijës me prindin nuk është në interesin më të lartë të fëmijës, njësia e mbrojtjes së fëmijës merr masa për largimin e përkohshëm të fëmijës nga prindi dhe e vendos fëmijën në kujdes të përkohshëm alternativ, sipas rregullave të përcaktuara në Kodin e Familjes dhe në këtë ligj.*

*3. Prindërit e fëmijës, pavarësisht faktit se cili prej tyre ushtron përgjegjësinë prindërore, kanë të drejtë të marrin informacion dhe asistencën e nevojshme për mirërritjen, kujdesin dhe edukimin e*



fëmijës, të marrin informacion për fëmijën nga shkolla, njësitë e shërbimit shëndetësor ose çdo institucion tjetër në kontakt me fëmijën.

4. Në rast se të dy prindërit ushtrojnë përgjegjësinë prindërore, por nuk bashkëjetojnë me njëri-tjetrin, vendimet lidhur me zgjedhjen e edukimit ose trajnimit profesional, trajtimet mjekësore komplekse ose ndërhyrjet kirurgjikale, vendbanimin e fëmijës ose administrimin e pasurisë së tij, merren me pëlqimin e të dy prindërve.

5. Në rast se njëri nga prindërit nuk jep pëlqimin e tij për të marrë vendim, lidhur me çështjet e parashikuara në pikën 4, të këtij neni, ose kur ai nuk mund të kontaktohet për shkak të vendndodhjes së panjohur ose për shkak të nevojës urgjente për të marrë vendim lidhur me fëmijën, vendimet merren nga prindi që jeton me fëmijën, përveç rasteve kur vendimi nuk është në interesin më të lartë të fëmijës.

6. Në rast të mosmarrëveshjes ndërmjet prindërve lidhur me ushtrimin e të drejtave prindërore dhe realizimin e detyrimeve të tyre ndaj fëmijës, cilido prej tyre mund të kërkojë zgjidhjen e mosmarrëveshjes nga gjykata kompetente. Pasi të jenë dëgjuar të dy prindërit, si dhe të jetë marrë mendimi i fëmijës, gjykata vendos në përputhje me interesin më të lartë të fëmijës”.

Ligji, në nenin 34, të tij, ka përcaktuar se cilët janë mekanizmat këshillimorë dhe koordinues institucionalë dhe strukturat për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, duke specifikuar se: “.....

4. Strukturat për mbrojtjen e fëmijës në nivel vendor janë:

a) bashkia;

b) struktura përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki;

c) njësia për mbrojtjen e fëmijës pranë strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki;

ç) njësia e vlerësimit të nevojave dhe referimit pranë bashkisë apo njësive administrative;

d) punonjësi i mbrojtjes së fëmijës pranë njësisë për mbrojtjen e fëmijës dhe njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit.

5. Mekanizmat dhe strukturat në nivel qendror e vendor bashkëpunojnë dhe koordinojnë punën ndërmjet tyre për zbatimin e legjisllacionit e të politikave shtetërore për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës. Bashkërendimi i veprimtarisë së tyre për çështje që lidhen me të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, të parashikuara në këtë ligj, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

6. Këta mekanizma dhe struktura bashkëpunojnë me organizatat jofitimprurëse për realizimin e politikave kombëtare e vendore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, si dhe për ofrimin e shërbimeve të nevojshme për mbrojtjen e tyre, në bazë të rregullave të hollësishme, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

7. Avokati i Popullit monitoron zbatimin e këtij ligji në përputhje me Konventën për të Drejtat e Fëmijëve, në zbatim të detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr. 8454, datë 4.2.1999, “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar”.

Neni 49 “Njësia për mbrojtjen e fëmijës”, detajon si më poshtë citohet:

“1. Njësia për mbrojtjen e fëmijës në bashki ngrihet dhe funksionon si njësi e posaçme brenda strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në nivel bashkie dhe ka për detyrë, në mënyrë të

*posaçme, parandalimin, identifikimin, vlerësimin, mbrojtjen dhe ndjekjen e rasteve të fëmijës në rrezik dhe/ose në nevojë për mbrojtje.*

*2. Punonjësit e njësisë për mbrojtjen e fëmijës, përfshirë drejtuesin e saj, janë punonjës për mbrojtjen e fëmijës, me formim punonjës socialë.*

*3. Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës, pranë njësisë për mbrojtjen e fëmijës, përveç detyrave të parashikuara në nenin 51, të këtij ligji, është përgjegjës dhe ka për detyrë:*

*a) të mbështesë punonjësin për mbrojtjen e fëmijës në nivel njësie administrative, për menaxhimin e rasteve të fëmijës në nevojë për mbrojtje;*

*b) të hedhë informacionin për fëmijët në nevojë për mbrojtje, masat e mbrojtjes dhe planet individuale të mbrojtjes në bazën e të dhënave përkatëse, të miratuar nga ministri përgjegjës që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës, në nivel bashkie dhe njësie administrative;*

*c) të mbikëqyrë mbarëvajtjen dhe progresin e fëmijës në nevojë për mbrojtje në njësitë administrative të bashkive, për të cilin është marrë masë mbrojtjeje ose është hartuar Plan Individual Mbrojtjeje;*

*ç) t'i raportojë, periodikisht, Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës të dhënat statistikore që ka përpunuar për fëmijët në nevojë për mbrojtje në territorin e bashkisë dhe njësive administrative përkatëse;*

*d) të identifikojë të gjithë aktorët dhe ofruesit e shërbimeve publike dhe jopublike të mbrojtjes së fëmijës në territorin e bashkisë, duke përfshirë përfaqësues nga shërbimet e kujdesit alternativ, të shërbimit shëndetësor, psikologjik, social, ligjor, punonjës të specializuar të rendit, përfaqësues të organit të prokurorisë dhe të institucioneve arsimore;*

*dh) të koordinojë funksionimin e grupit ndërsektorial në nivel bashkie dhe/ose njësie administrative, për identifikimin, analizën, mbrojtjen e fëmijës në nevojë për mbrojtje dhe referimin e ndjekjen në sistemin e drejtësisë të rasteve për masat e mbrojtjes dhe të dhunës në familje;*

*e) të ndërjegjësojë komunitetin, të organizojë takime informuese, edukuese dhe trajnuese për mbrojtjen e fëmijës në territorin e bashkisë/ komunës;*

*ë) të shërbejë si qendër informacioni, ku fëmijët dhe familjet në territorin e bashkisë mund të informohen apo të referohen te shërbime apo institucione të tjera mbështetëse, sipas nevojave që ata kanë.*

*4. Njësia për mbrojtjen e fëmijës në bashki harton dhe përshtat, një herë në vit, listën e përfaqësuesve proceduralë për fëmijët në konflikt me ligjin, fëmijët viktime dhe dëshmitarë në procesin penal dhe ia dërgon atë strukturave vendore të Policisë së Shtetit, Prokurorisë dhe gjykatës së rrethit gjyqësor e të apelit përkatës. Kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së përfaqësuesve proceduralë përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës dhe Ministrin të Drejtësisë.*

*5. Njësia për mbrojtjen e fëmijës ushtron çdo kompetencë tjetër, sipas legjislacionit në fuqi”.*

Nga këqyrja e dokumentacionit të depozituar, analizimi i provave, parashtrimeve të NJMF/Bashkia Shkodër, si dhe të legjislacionit në fuqi, Komisioneri konstaton se nga ana e NJMF/Bashkia Shkodër, është vepruar konform kompetencave e përgjegjësisë të saj, në përmbushje të

përcaktimeve ligjore, lidhur me menaxhimin e trajtimin e rastit, sipas informacioneve të kërkuara nga Agjencia Shtetërore e Mbrojtjes së Fëmijëve dhe Drejtoria Vendore e Policisë Shkodër.

Referuar dokumentacionit të shqyrtuar dhe informacionit të përcjellë nga ankuesja rezulton se, nga ana e subjektit ankues nuk është cituar ndonjë datë apo periudhë kohore e saktë, në të cilën të referohet kërkesa/ankesa e saj ndaj NJMF/Bashkia Shkodër, apo që të ketë kontaktuar me specialisten e Njesisë së Mbrojtjes së Fëmijëve të Bashkisë Shkodër dhe të ketë kërkuar ndihmë apo asistencë për fëmijën e saj D.M.

Nga analizimi i ligjislacionit në fuqi<sup>3</sup>, rezulton se shtetasit shqiptarë që banojnë jashtë vendit, ashtu si rasti objekt shqyrtimi, nuk përfitojnë shërbime të kujdesit shoqëror, që ofrohen nga njësitë e qeverisjes vendore.

Në përfundim të gjithë sa më sipër, Komisioneri konstaton se, nga ana e NJMF/Bashkia Shkodër janë ndërmarrë të gjithë hapat e duhur për shqyrtimin e rastit dhe informimin e institucioneve përkatëse, lidhur me situatën sociale të znj. M.M.

Për rrjedhojë, në këtë kontekst, Komisioneri konstaton se, nuk ka patur veprime apo mosveprime të NJMF/Bashkia Shkodër që të ketë vënë në pozita të pafavorshme znj. M.M.

Në mungesë të trajtimit të padrejtë e të pafavorshëm të ankueses, bie poshtë edhe pretendimi për diskriminim, i cili në thelb do të duhet të kishte pikërisht konstatimin e trajtimit të pabarabartë apo të pafavorshëm të fëmijës së ankueses, të lidhur domosdoshmërisht me “shkakun” e pretenduar.

Për sa më sipër, në referencë të nenit 7, pika 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri gjykon se ankuesja nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm nga ana e Njesisë së Mbrojtjes së Fëmijëve të Bashkisë Shkodër.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të znj. M.M, për shkak të aftësisë së kufizuar, nga ana e Njesisë së Mbrojtjes së Fëmijëve të Bashkinë Shkodër, në fushën e të mirave dhe shërbimeve.

---

<sup>3</sup> Neni 7/a i ligjit 121/2016 “Për shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”.

2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**